



Prishtinë, 17 dhjetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1467_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 75 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 21.06.2021 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë, adresa Rr.Gustav Mayer 16, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 17 dhjetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. VAZHDOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë, me numër licence ZRRE/LI_34/12 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 29 dhjetor 2021 deri 28 dhjetor 2026.
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 21.06.2021 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë.



- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duhet dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë**, me datë 08 nëntor 2021 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
 - Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
 - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - Licenca e lëshuar me datë **29.12.2009** (Nr. i Licencës ZRRE/Li_34/09), e modifikuar me 12.10.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_34/12), e vazhduar deri me 29.12.2016, e vazhduar prap deri me 28.12.2021, do të vazhdojë të jetë e vlefshme, për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri më 28 dhjetor 2026, dhe mund të vazhdohet, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës dhe plotëson kushtet për vazhdim licence, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Të gjitha dispozitat e licencës së lëshuar me datë 29.12.2016 mbulohen me këtë licencë.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **GEN-I TIRANA Sh.P.K – Dega në Kosovë,**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe


Bordi I ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Haxhi, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar